



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

I	Data	22.01.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		109/02-2330	/.

## INFORMATË

**PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS  
NË VITIN 2023**

**Kaçanik, Janar 2024**

**PËRMBAJTJA:**

**HYRJE**

**QËLLIMI**

**ORGANET E KOMUNËS**

**PËRBËRJA E KUVENDIT**

**SHEFAT E GRUPEVE PARLAMENTARE**

**KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS**

**MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS**

**KOMITETET E KUVENDIT**

**EKZEKUTIVI I KOMUNËS**

**NJOFTIMET PËR MBLEDHJE**

**AKTIVITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS**

**RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS**

**MONITORIMI I MBLEDHJEVE**

**PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS**

**AKTET E DËRGUARA NË MAPL PËR SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE**

**AKTET E RISHQYRTUARA SIPAS KËRKESËS SË MAPL**

**AKTIVITETE TË TJERA**

**SHËRBIMI I KUVENDIT**

**PËRFUNDIM**

**SHTOJCA:**

**EVIDENCA E AKTEVE TË APROVUARA DHE RAPORTIMET E KRYETARIT**

**I. RREGULLORET**

**II. VENDIMET**

**III. RAPORTIMET E KRYETARIT TË KOMUNËS**

## Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës, Kuvendi është organi më i lart vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

## Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim, informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe grupeve tjera të interesit, funksionimin e Kuvendit të Komunës të legjislaturës shtatë (7) në aktivitetin e vitit 2023. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

## Organet e Komunës

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, janë :

1. Kuvendi i komunës; dhe
2. Kryetari i komunës.

Kuvendi i Komunës, është organi më i lartë vendimmarrës në komunë, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës, në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ( neni 35.1).

Kryetari i Komunës, zgjidhet në zgjedhjet e drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale (neni 56.1).

Konstituimi i organeve të Komunës Kaçanik është bërë me 08 dhjetor 2021. Me këtë datë është bërë edhe zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit, i cili udhëheq me mbledhjet e KK, sipas detyrës zyrtare edhe me mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF.

## Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës i dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 17 tetor 2021, është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 5 subjekte politike me numër të mandateve: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 12 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 8 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 2 mandate, Nisma për Kosovën (NISMA) me 1 mandat. Shumicën në KK e përbëjnë subjekti politik i Partisë Demokratike të Kosovës -PDK në koalicion me subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK.

Sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite. 37.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar: a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij; b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur; c) nëse

anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij; d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhëri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj; e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye; 12 f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të pa për zgjidhshëm. 37.3 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lista e 27 anëtarëve të zgjedhur të Legjislaturës së shtatë (7):

1	2	3	4
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Përkatësia politike
01.	Kemal Murseli	Kryesues i Kuvendit	PDK
02.	Brahim Imishti	anëtar	PDK
03.	Hamide Luma	anëtar	PDK
04.	Kadri Krivenjeva	anëtar	PDK
05.	Fitore Vishi	anëtar	PDK
06.	Rrustem Zenuni	anëtar	PDK
07.	Edon Baftiu	anëtar	PDK
08.	Selajdin Troni	anëtar	PDK
09.	Fatmir Bunjaku	anëtar	PDK
10.	Bashkim Krasniqi	anëtar	PDK
11.	Florina Lika-Vishi	anëtar	PDK
12.	Lejla Muhaxheri-Çaka	anëtar	PDK
13.	Agim Mani	anëtar	LVV
14.	Kadrije Lika-Troni	anëtar	LVV
15.	Adnan Reka	anëtar	LVV
16.	Naim Beça	anëtar	LVV
17.	Raif Kasa	anëtar	LVV
18.	Ernesta Krasniqi	anëtar	LVV
19.	Bashkim Luma	anëtar	LVV
20.	Arta Avdiu	anëtar	LVV
21.	Ardita Rrahmani	anëtar	LDK
22.	Besnik Salihu	anëtar	LDK
23.	Betim Shala	anëtar	LDK
24.	Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	LDK
25.	Rabije Sallahi	anëtar	AAK
26.	Ekrem Livoreka	anëtar	AAK
27.	Agim Çaka	anëtar	NISMA

Renditja e anëtarëve si në listë, Brahim Imishti nuk është në bazë të numrit të votave të fituara, por ulësen e ka fituar në zëvendësim të Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi, i cili ka qenë bartës i listës së PDK, por për shkak të pozitës së tij të zgjedhur kryetar komune, e ka liruuar pozitën për anëtar të KK.

### **Shefat e Grupeve Parlamentare:**

1. Nga PDK, Shef i GP -Rrustem Zenuni, 12 ulëse
2. Nga LVV Shef i GP -Agim Mani, 08 ulëse
3. LDK Shef i GP - Ardita Rrahmani, 4 ulëse
4. Në emër të AAK, fjalën e merr Ekrem Livoreka, 2 ulëse
5. Në emër të NISMA, fjalën e merr Agim Çaka, 1 ulëse.

### **Kompetencat e Kuvendit të Komunës**

Kompetencat e Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL). Sipas nenit 40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Sipas nenit 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësitë të tjera që kërkohen me ligj.

### **Mbledhjet e Kuvendit të Komunës**

Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja për Punë të Kuvendit të Komunës (kapitulli VII dhe VIII), përcaktojnë rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca të rregullta në vit respektivisht deri në 12 mbledhje me pagesë, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, anëtarët e KK kanë pagë të rregullt mujore.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për gjatë vitit 2023 ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta, nga 12 mbledhje të planifikuara me Planin e punës së KK për vitin 2023. Gjatë vitit 2023 është mbajtur një mbledhje Solemne me 17 shkurt, në përvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës të 17 shkurtit 2008. Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në sallën e kuvendit dhe kanë qenë të hapura për publikun.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, janë mbajtur në datat si në tabelë:

Kuvendi i Komunës Kaçanik	Mbledhje Rrregullta	Mbledhje të Jashtëzakon.	Mbledhje Urgjente	Mbledhje Solemne
Muajt	Njëmbëdhjetë (11) Mbledhje	-	-	Një (1) Mbledhje
Janar	31.01.2023	-	-	-
Shkurt	27.02.2023	-	-	17.02.2023
Mars	31.03.2023	-	-	-
Prill	28.04.2023	-	-	-
Maj	30.05.2023	-	-	-
Qershor	30.06.2023	-	-	-
Korrik	31.07.2023	-	-	-
Shtator	27.09.2023	-	-	-
Tetor	31.10.2023	-	-	-
Nëntor	30.11.2023	-	-	-
Dhjetor	28.12.2023	-	-	-

Pjesëmarrja e anëtarëve të KK në mbledhjet e rregullta ka qenë kryesisht e rregullt me ndonjë mungesë me arsye të ndonjë anëtari, ndërkaq për arsye të ndryshme ka pasur anëtarë që nuk kanë qëndruar në mbledhje deri në fund, ndërkaq ka pasur bojkotim të 2 mbledhjeve nga 7 anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje. 1. Në mbledhjen e 8 të datës 27.09.2023, duke u thirrur në dërgim Jo me kohë të materialit të kësaj mbledhje, ndërhyrjen e Kryesuesit të KK në fjalën e anëtarëve të caktuar të opozitës, mos përgjigje me kohë e Ekzekutivit të Komunës në pyetje dhe kërkesa. 2. Në mbledhjen e 10 të datës 30.11.2023, duke u thirrur në mos përgjigje të Kryetarit të Komunës në një pyetje të ngritur në mbledhjen e kaluar të KK.

### Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka të formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa; dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Komiteti për Politikë dhe Financa është në përbërje prej 7 anëtarëve:

- |                     |     |                           |
|---------------------|-----|---------------------------|
| 1. Kemal Murseli    | PDK | Kryesues sipas funksionit |
| 2. Kadri Krivenjeva | PDK | anëtar                    |
| 3. Fitore Vishi     | PDK | anëtar                    |

4. Agim Mani	LVV	anëtar
5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Rabije Sallahi	AAK	anëtar.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interes të përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje nga 12 të planifikuara, duke shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, çështjet financiare dhe çështje të tjera me rëndësi për komunën, rregullores komunale, raporteve financiare. Aktiviteti i këtij komiteti në formë me të gjerë do të raportohet me raport të veçantë të punës.

Komiteti për Komunitete, është në përbërje, 5 anëtarë;

1. Ekrem Livoreka	AAK	Kryesues
2. Lejla Muhaxheri –Çaka	PDK	anëtar
3. Arta Avdiu	LVV	anëtar
4. Betim Shala	LDK	anëtar
5. Arben Thaqi	OJQ/ Shoqëria civile	anëtar.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje që kanë qenë të parapara me Planin e punës të së këtij komiteti. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve. Aktiviteti i këtij komiteti në formë me të gjerë do të raportohet me raport të veçantë të punës. Kur jemi të komitetet obligative të KK, kompensimi bëhet për pjesëmarrje në mbledhje edhe sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, ndërkaq problem ka pasur në kompensimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete nga OJQ/ shoqëria civile Arben Thaqi. Kuvendi i Komunës nga viti 2019 e ka pasur të formuar një (1) Komitet Konsultativ: Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Ky Komitet aktivitetin e tij e ka filluar nga muaji shtator 2019, ndërkaq gjatë vitit 2023 nuk ka mbajtur ndonjë mbledhje, për shkak se anëtarët e këtij komiteti në vazhdimësi kanë ofruar dorëheqje. Dorëheqjet e fundit janë aprovuar në KK nga 3 anëtarë të këtij komiteti me 31.03.2023, me çka është ardhur deri të shpërbërja e këtij komiteti.

### **Ekzekutivi i Komunës Kaçanik**

Në vitin 2023, Ekzekutivi i Komunës ka punuar me këtë përbërje:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës

Drejtorët e drejtorive komunale:

1. Dardana Tafili- Dauti- Drejtorja e Administratës së Përgjithshme;
2. Sali Malsiu- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale
3. Zahir Doda- Drejtorja e Arsimit;
4. Bahri Selimi- Drejtorja e Buxhetit dhe Financave;
5. Qamil Stagova- Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
6. Ramadush Osmani- Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;

7. Suhad Dullovi- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
  8. Hafize Sallahi- Drejtoria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit;
  9. Pranvera Loku-Zharku- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
- Ylber Bajra- Shef i kabinetit të Zyrës së Kryetarit.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka formuar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili këshill ka raportua sipas Udhëzimit Administrativ që rregullon formimin, detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilli. Kryesues i KKSBB është Kryetari i Komunës Besim Ilazi, sipas detyrës zyrtare. KKSBB në vitin 2023 ka mbajtur 6 mbledhje, ashtu siç e parasheh UA. Aktiviteti i KKSBB në formë me të gjerë paraqitet me raport të veçantë.

Gjatë periudhës raportuese Kuvendi i Komunës ka formuar komisione me mandat të caktuar dhe komisione ad hoc, si: Komisioni përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore; Komisioni për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2024, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, -për çdo vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të cilat komisione kanë dhënë rekomandime për ofertat me të suksesëshme sipas shpalljes publike, Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, me mandat 2 vjeçar, ashtu siç e përcakton ligji, i cili komision është ndryshuar dhe plotësuar për shkak të balancimit gjinor. Për me gjerë, aktiviteti i komisioneve me mandat të caktuar dhe ad hoc paraqitet me raporte të veçanta. Kur jemi të komisionet e kuvendit, sfidë mbetet mungesa e bazës ligjore për kompensimin e tyre.

### **Njoftimet për mbledhje**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, kryesisht ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes, Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje edhe materialet e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në formë elektronike, pasi anëtarët e KK janë të pajisur me laptop.

Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e komunës dhe në facebookun zyrtar të komunës. Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal (MAPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive komunale, Zyrës së Informimit, Zyrës së IT si dhe OSBE.

### **Aktiviteti i Kuvendit të Komunës**

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023, Kuvendi i Komunës ka pasur në rend pune gjithsej 108 pikë. Në kuadër të rregullat-ivës normative, KK ka aprovuar: Rregullore nr.01/2023 për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj “në komunën e Kaçanikut 01Nr.09-104/02-14211/23. Gjatë vitit 2023 Kuvendi i Komunës ka miratuar 67 Vendime, Aktet e miratuara ndikojnë në krijimin e kushteve sa më të mira të qytetarëve të komunës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, ka marrë vendime për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prona komunale për 99 vjet, vendim për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për 15 vjet për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, ndërkaq ka marrë vendime për këmbimin e pronave, ndërrimin e destinimit të pronave



bujqësore, drutë e konfiskuara t'ua ndajë shkollave. KK ka aprovuar vendime të karakterit financiar (rialokim, bartje, transfere) të mjeteve buxhetore sipas propozim vendimeve të Kryetarit të Komunës, për një shpenzim më të mirë buxhetor dhe me qëllim që mjetet buxhetore mos të ngelin në suficit buxhetor. Gjatë vitit 2023 Kuvendi i Komunës ka diskutuar Planin e punës së ekzekutivit për vitin 2023, Nga aktet tjera, KK ka aprovuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026, Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026, Planin për integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve dhe plane tjera, ndërkaq ka shqyrtuar gjithsej 21 raporte, 4 prej tyre janë raporte financiare, 7 raporte për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, Raport i KRM "Pastërtia për menaxhimin e parkingjeve publike. Raportin e menaxhimit të burimeve njerëzore për vitin 2022, Raportet dhe Planet e Komiteteve të KK, Raporte dhe Plani i KKSB, Raporte (Informata) që lidhen me aktivitetin e shkollave për fillimin apo përfundimin e vitit shkollor. Është aprovuar Iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave;

Në vitin 2023 është bërë shpërbërja e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, pasi 3 anëtarë të këtij komiteti kanë ofruar dorëheqje, në pamundësi për me zhvilluar aktivitete, në mungesë të kuorunit. Gjatë periudhës raportuese vlen të përmenden se për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatoj Kuvendi i Komunës në seancën e vet, paraprakisht Komiteti për Politikë dhe Financa i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet, ndërkaq pjesa dërmuese e çështjeve kanë pasur për bazë Propozim Vendimet, Propozim Rregulloret, Draft Planet, të propozuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorive Komunale. Aktiviteti i Kuvendit të Komunës Kaçanik mund të vlerësohet së ka qenë i mirë, ka pasur bojkotim të 2 mbledhjeve nga 7 anëtarë të subjektit politik LVV. Çështjet kryesisht janë aprovuar me shumicë votash, disa nga çështjet (21) janë miratuar njëzëri. Për me gjerë është lista bashkëngjitur e miratimit të akteve. Gjatë periudhës raportuese është lajmëruar një anëtar për konflikt të interesit të anëtarëve të KK. Sfidë në zhvillimin e aktiviteteve të KK, mbeten kushtet e punës për mbledhje të KK, për shkak të sallës jo të përshtatshme dhe mungesa e foltores.

### **Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës**

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raporti i Kryetari para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës në vitin 2023, ku forma e raportimit financiar ka qenë me shkrim katër (4), ndërkaq në formë verbale çdo herë kur është kërkuar. Një (1) herë është raportuar për aktivitetin e përgjithshëm të komunës, një (1) herë për menaxhimin e burimeve njerëzore. Kryetari ka raportuar përmes shërbimeve përkatëse profesionale, 1 herë për çështjen e auditimit të brendshëm, dy (2) herë për zbatimin e rekomandimeve, tre (3) herë është raportuar për çështjen e arsimit. Gjithashtu ekzekutivi i komunës është përgjigjur në formë të shkruar disa Kërkesave dhe Pyetje të anëtarëve të KK, ndërkaq KK ka kërkuar të merr përgjigje me shkrim për çdo pyetje dhe kërkesë. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës.

## Monitorimi i mbledhjeve

Aktivitetit i Kuvendit monitorohet nga strukturat ndërkombëtare - OSBE-ja e cila i përcjellë mbledhjet e KK dhe KPF nga Faruk Dermaku, ndërkaq një mbledhje të KPF e ka monitoruar Rrezart Mehmeti. Nga strukturat vendore, monitorimi është bërë nga Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës nga zyrtari, Vlora Ahmetaj. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo interesimi i OJQ të tjera, qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit ka qenë minimal, pasi që mbledhjet transmetohen drejtpërdrejtë, formë kjo shumë e mirë për të gjithë qytetarët, OJQ dhe grupet tjera të interesit me i përcjellë punimet e kuvendit.

### Publikimi i akteve në Ueb faqen zyrtare të Komunës

Gjatë periudhës raportuese, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës dhe shkresat tjera të lëndës, dërgohen të skanuara nga Sektori i Kuvendit, Zyrës së Informimit përkatësisht Zyrës së IT për t'i publikuar në Ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjeve të KPF-së, të Komitetit për Komunitete si dhe procesverbalin e dëgjimit publik të organizuara nga Kryesuesi i Kuvendit përmes KPF-së lidhur me buxhetin e Komunës. Vlen të përmendet së, i gjithë aktiviteti i Kuvendit të Komunës i vitit 2023 publikohet në faqen zyrtare të komunës, me përjashtim të vendimeve që kthehen në rishqyrtim nga organi shqyrtues, ndërkaq nuk është publikuar Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale 00150-0 dhe 00151-0 në zonën kadastrale Kaçanik, për shkollën në Dushkajë, për shkak të problemeve me AKP.

Kjo mënyrë e publikimit, mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare. Për t'iu qasur aktivitetëve të Komunës Kaçanik duhet klikuar adresën: <https://kk.rks-gov.net/kacanik/>, Duke klikuar linkun: Kuvendi, hapen Linqet: Rregulloret, Vendimet, Procesverbalet, Buxheti, Video-incizime, Dokumente dhe aktivitete tjera të Kuvendit të Komunës sipas viteve.

### Aktet e dërguar në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës raportuese të gjitha aktet e miratuara për të cilat kërkohet shqyrtim i ligjshmërisë sipas LVL, janë dërguar Zyrës Ligjore të MAPL. Aktet të cilat janë dërguar në MAPL sipas mbledhjeve:

Aktet e miratuara në mbledhjen e parë (1) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 31.01.2023, listuar si në tabelë nga 1-8, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale 00150-0 dhe 00151-0 në ZK Kaçanik, për objektin e SHMU "Emin Duraku" Kaçanik	18 Prezentë 26	8	-	01Nr. 464/01-1849/23

2.	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për (99) vjet pronë e paluajtshme të komunës përmes Shprehjes së Interesit, NTP GREEN PRODUCT, Ferizaj	15 Prezentë 25	8	2	01Nr. 104/02-29976/22
3.	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për (99) vjet pronë e paluajtshme të komunës përmes Shprehjes së Interesit, XHEMILE VISHI B.I., Ferizaj	14 Prezentë 24	8	2	01Nr. 104/02 29994/22
4.	Vendim për aprovimin e planit vjetor të punës i këshillit komunal të sigurisë në bashkësi për vitin 2023	18 Prezentë 23	4	1	01 Nr. 104/02-1280/23
5.	Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023	26 Prezentë 26	-	-	01Nr.60/01-1325/23
6.	Vendim për aprovimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027	26 Prezentë 26	-	-	01Nr. 104/02- 1493/23
7.	Vendim për Aprovimin e Raportit të punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2022	25 Prezentë 25	-	-	01Nr. 060/01-2599/23
8.	Vendimi për Aprovimin e Kërkesës së Mirlinda Hysa (Axhami) për dorëheqje nga Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.	25 Prezentë 25	-	-	01Nr. 60/01-33703/22

Aktet e miratuara në mbledhjen e dytë (2) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 27 shkurt 2023, listuar si në tabelë nga 1-3, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendim për subvencionim të fermerëve	26 Prezentë 26	-	-	01Nr. 08-320/01-3884/23
2.	Vendim për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	25 Prezentë 26	-	1	01Nr. 09-660/01-4005/23

3.	Vendim për aprovimin e Raportit të punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022	26 Prezentë 26	-	-	01Nr. 60/01-3910/23
----	----------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------	---	---	---------------------

Aktet e miratuara në mbledhjen e tretë (3) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 31 mars 2023, listuar si në tabelë nga 1-3, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës të vitit 2023	27 Prezentë 26	-	1	01Nr.400/01-7056/23
2.	Vendimi për miratimin e Iniciativës për Bashkëpunim Ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.	27 Prezentë 27	-	-	01Nr.07-104/01-7011/23
3.	Vendimi për aprovimin e dorëheqjes së Antigona Axhami-Baftijaj, Fiknete Krasniqi dhe Edita Shehu nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara	27 Prezentë 27	-	-	01Nr. 60/01-7136/23

Aktet e miratuara në mbledhjen e katërt (4) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 28 prill 2023, listuar si në tabelë nga 1-4, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023	15 Prezentë 26	7	4	01Nr. 400/03-9058/23
2.	Vendim për transferin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore	15 Prezentë 26	7	4	01Nr. 104/01-9164/23
3.	Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, të pjesës së parcelës kadastrale nr. 00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime Kaçanik	18 Prezentë 26	5	3	01Nr. 104/02-9142/23

4.	Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronën komunale me pronën private	17 Prezentë 25	7	1	01Nr. 350/01-9205/23
----	---------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------	---	---	----------------------

Aktet e miratuara në mbledhjen e pestë (5) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 30 maj 2023, listuar si në tabelë nga 1-10 përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendimi për miratimin e Planit komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut, 2023-2025	26 Prezentë 26	-	-	01Nr. 104/02-11152/23
2.	Vendimi për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-7676/22 për dhënien në menaxhim të përkohshëm parkingjet në pronësi të komunës, ndërmarrjes publike KRM “ Pastërtia, Sh. A- Njësia në Kaçanik	15 Prezentë 25	3	7	01Nr. 104/02-11552/23
3.	Vendimi për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore	14 Prezentë 26	10	2	01Nr. 104/02-11739/23
4.	Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00382-2 ZK Bajnicë, në emër të Xhemal Fazli, për këmbim me pjesët e parcelave 00379-0; 00384-0, pronë shoqërore rrugë publike	17 Prezentë 26	7	2	01Nr. 941/01-11794/23
5.	Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00439-1, ZK Duraj, në emër të Adem Salihaj, për këmbim me pjesën e parcelës 00452-0, pronë shoqërore rrugë publike	16 Prezentë 25	7	2	01Nr. 941/01-11793/23
6	Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00905-2, ZK Nikaj, në emër të Fatmir Gula, për këmbim me pjesën e parcelës 00920-1, pronë shoqërore rrugë publike	15 Prezentë 24	6	3	01Nr. 941/01-11795/23

7	Vendimi për shpallje me interes publik pjesët e PK 00980-0; 00982-0, ZK Kaçanik në emër të Naser Dema, për këmbim me PK 00979-0, pronë komunale	17 Prezentë 25	6	2	01Nr. 941/01-11792/23
8.	Vendim për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS	25 Prezentë 25	-	-	01Nr. 104/02-11896/23
9.	Vendim për Aprovimin e Raportit të punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2022.	25 Prezentë 25	-	-	01Nr. 60/01-11954/23
10	Vendim për organizimin e një punëtorie njëditore me anëtarët e kuvendit të komunës Kaçanik për Planin Zhvillimor Komunal	20 Prezentë 25	2	3	01Nr.104/02-13186/23

Aktet e miratuara në mbledhjen e gjashtë (6) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 30.06.2023, listuar si në tabelë nga 1- 8, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës "Xheladin Kurtaj" në komunën e Kaçanikut	23 Prezentë 26	-	3	01Nr.09-104/02-14211/23
2.	Vendim për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024- 2026	14 Prezentë 26	10	2	01 Nr. 400/01-14264/23
3.	Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023	17 Prezentë 24	-	7	01 Nr. 400/01-14258/23
4.	Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik	13 Prezentë 25	10	2	01Nr. 104/02-13790/23

5.	Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës	23 Prezentë 25	-	2	01Nr. 104/02-13788/23
6.	Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës	18 Prezentë 25	-	7	01 Nr. 08-322/14537/23
7.	Vendimi për shtyrjen e zbatimit të vendimit 01nr. 104/02-9142/23 i datës 28.04.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pjesës së PK nr. 00516-1 ZK Kaçanik për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin Nerodime	17 Prezentë 22	-	7	01Nr. 104/02-14383/23
8.	Vendimi për konstatim të vendimit 01nr. 104/02-11896/23 i datës 30.05.2023 se është në harmoni me dokumentet si në kërkesën e MMPHI nr.3041-2/23 të datës 12.06.2023 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit	15 Prezentë 22	6	1	01Nr. 104/02-14399/23

Aktet e miratuara në mbledhjen e shtatë (7) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 31.07.2023, listuar si në tabelë nga 1- 5, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesë të parcelave kadastrale 00463-2, 00464-4.Në emër të Zejnullah Burrniku dhe 00463-1. Në emër të Jakup Burrnikut, Z.K. RUNJEVË. Për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00471-0 ,pronë shoqërore, rrugë pubike.	12 Prezentë 25	-	13	06Nr.350/01-17440/23
2.	Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale 00194-10 ,Z.K.BEGRACË, në emër të Shkumbin Luzha.Për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 2420-3, pronë shoqërore ,rrugë publike.	13 Prezentë 25	-	11	06 Nr.350/01-17441/23

3.	Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.60/01-33331/22 ,të datës 29.12.2022 -Për ndryshim plotësimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01NR.104/02-19963 ,të datës 02.09.2022- Për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.	24 Prezentë 25	-	1	01Nr. 60/01-17846/23
4.	Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit paraparak 01NR.104/02-13790/23, të datës 30.06.2023 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurte.	13 Prezentë 25	5	7	01Nr.104/02-18514/23
5.	Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01NR.104/02-13788/23 të datës 30.06.2023 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.	13 Prezentë 25	5	7	01Nr.104/02-18517/23

Aktet e miratuara në mbledhjen e tetë (8) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik, të datës 27.09.2023, listuar si në tabelë nga 1- 9, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundë r	Abstenim	
1.	Vendimi për miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026	15 Prezentë 20	5	-	01Nr.400/03-24314/23
2.	Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023	15 Prezentë 20	4	1	01 Nr. 400/01-24273/23
3.	Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi	20 Prezentë 20	-	-	01 Nr. 60/01-24306 /23



4.	Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.08-320/01-23594/23 të komisionit profesional për vlerësimin e dëmeve nga reshjet breshëri në fushën e bujqësisë në komunën e Kaçanikut në f. Biçec	20 Prezentë 20	-	-	01Nr. 320/01-24456/23
5.	Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik	15 Prezentë 20	4	1	01Nr. 104/02-24407/23
